

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 143 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-2018/1 datë 23.04.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2239/3 datë 10.05.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 21-të mbajtur më 10.05.2024, miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik

- PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, për shkak se në paketën e saj programore nuk ka siguruar (ofruar) shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv, gjegjësisht nuk kryen ritransmetim të shërbimeve programore „TVM 2“, „TVM 4“ dhe „TVM 5“, që është në kundërshtim me nenin 143 paragrafi (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-2018/1 datë 23.04.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.
- URDHËROHET** operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjegjësisht në paketën programore detyrimisht dhe pa pagesë të përfshijë të gjitha shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv.
- Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes i cakur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik.
- Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk vepron sipas aktvendimit, pra vazhdon të kryejë shkeljen për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 2 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, do të paraqes kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.
- Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e çertifikimit në arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

A r s y e t i m

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në pajtim me nenin 6 paragrafi (1) nënparagrafi 4 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) ndërmerr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur është kryer shkelja e dispozitave të LSHMAAV ose të rregullave miratuar në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve nga lejet.

Në bazë të nenit 28 nga LSHMAAV, Agjencia është kompetente të kryejë mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele me kërkesë, si dhe ndaj paketave programore që i ritransmetojnë operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave të këtij ligji, lejeve, çertifikatave të dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 të LSHMAAV, Agjencia më datë 22.04.2024, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore të shërbimeve programore, ritransmetuar nga ana e operatorit të rrjetit publik, Shoqërisë për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, nga ku është konstatuar se operatori në fjalë, i cili sipas notifikacionit të Agjencisë për Komunikime Elektronike, mund të kryejë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në paketën e tij programore nuk ka ofruar shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv, gjegjësisht nuk kryen ritransmetim të shërbimeve programore „TVM 2“, „TVM 4“ dhe „TVM 5“, që është në kundërshtim me nenin 43 paragrafi (3) të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë specifikuar në mënyrë të detajuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-2018/1 datë 23.04.2024, që është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20, neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 143 paragrafi (3) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-2018/1 datë 23.04.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2239/3 datë 10.05.2024, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, të cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, miratoi aktvendim ku ndaj subjektit të lartpërmendur ndërmirret masë paralajmërim publik dhe urdhërohet që menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të harmonizon veprimtarinë e tij me dispozitat e LSHMAAV, në mënyrë që në paketën programore detyrimisht dhe pa pagesë t'i përfshij të gjitha shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv.

Agjencia do kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim për të përcaktuar nëse subjekti në fjalë ka vepruar sipas urdhrit, gjegjësisht sipas aktvendimit për ndërmarrje të masës – paralajmërim publik.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij operatori ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër, është marrë aktvendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Shtojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-2018/1 datë 23.04.2024.